

VENDIM
Nr. 128, datë 31.5.2022

**MBI REFUZIMIN PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “GREEN ENERGY BILISHT”
SHPK, NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA
CENTRALI FOTOVOLTAIK, ME KAPACITET TË INSTALUAR 2000 kW**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; si dhe nenit 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016; dhe nenit 15, germa “a”, të rregullore “Për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 31.5.2022, mbasi shqyrtoi relacionin e përparësuar nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes me nr. 830/8 prot., datë 27.5.2022, “Mbi fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë ‘Green Energy Bilisht’ sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik 2 mw”,

konstatoi se:

- Shoqëria “Green Energy Bilisht” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 448 prot., datë 4.4.2022, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2000 kW.

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 80, datë 13.4.2022, filloi procedurën për shqyrtimin e kërkesës së shoqërisë “Green Energy Bilisht” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2000 kW.

- Me shkresën nr. 448/1 prot., datë 21.4.2022, shoqëria është njoftuar për të plotësuar dokumentacionin e munguar sipas nenit 9, pika 2, gjerat “a”, “d”, “f”; nenit 9, pika 3, gjerat “b”, “c”; neni 9, pika 4.1.4; neni 9, pika 4.4.5.

- Shoqëria nuk ka plotësuar dokumentacionin e munguar dhe në zbatim të nenit 14, pika 1, të rregullores “Për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, e ndryshuar, Bordi i ERE-s e merr vendimin përfundimtar për pranimin ose refuzimin e aplikimit për licencë në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike brenda 60 ditëve pune nga data e publikimit të parë në shtyp të njoftimit për aplikimin në shtyp.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të refuzojë licencimin e shoqërisë “Green Energy Bilisht” sh.p.k., në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga centrali fotovoltaik, me kapacitet të instaluar 2000 kW.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti